



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 45-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 30.06. 2021, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Fitim Shala, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Naim Jahiri, anëtar
7. Naim Stullca, anëtar
8. Majlinda Sylejmani, anëtare
9. Ramadush Tasholli, anëtar
10. Arif Miftari, anëtar
11. Fatime Krasniqi, anëtare
12. Xhyzide Rustemi, anëtare
13. Lulzim Rustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Egzona Bytyqi, anëtare
16. Nazmi Krasniqi, anëtar
17. Lumturije Bytyqi, Hasani, anëtare
18. Shkelzen Bislimi, anëtar
19. Albulena Kelmendi, anëtare
20. Alban Salihu, anëtar
21. Afrim Miftari, anëtar
22. Hajdin Bytyqi, anëtar
23. Safete Amerllahu, anëtare
24. Bashkim Budakova, anëtar
25. Ukë Kryeziu, anëtar
26. Ganimete Qeriqi, anëtare
27. Manush Shamolli, anëtar
28. Fehmi Rexhepi, anëtar
29. Argjend Tasholli, anëtar

30. Egzona Fazlija, anëtare
31. Arben Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Fauz Xhemajli, Nënkyetar i Komunës
3. Latif Ramadani DBF
4. Anila Reçica, DKRS
5. Emina Rexhiq, DPU
6. Valon Pacolli, DA
7. Bekim Shabani, DEZH
8. Sefer Tasholli, DGJK
9. Merita Bytyqi, DSH
10. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës
11. Nazim Gashi, DMSH
12. Dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha së pari ju uroj të jeni mirë dhe të keni shëndet.

Pastaj tha se në mbledhje prezantojnë shumica e anëtarëve të Kuvendit; Rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 32 – të.
2. Propozim Vendim për aprovimin e kornizës afatmesme buxhetore për vitet 2022-2024
3. Propozim rregullore për transparencën në komunë
4. Propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e shtëpisë të komunitetit në vendbanimin në Gandime të Ulët.
5. Propozim rregullore për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve.
6. Propozim rregullore për taksat komunale
7. Propozim Vendim për anulimin e vendimit 15Nr .30-30026 për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmërive në funksion të ndërtimit të segmenteve rrugore “ Afrim Zhitia ” , “ Mbreti Zog ” dhe “ Kongresi i Blinajës ” në Lipjan .

Pastaj kryesuesi tha se me kërkesë të Kryetarit të Komunës kemi edhe një pike shtesë Propozim Vendim për Ridestinimin e mjeteve. Ku për këtë pike e ka marrë

edhe rekomandimin e KPF-s për Kuvend. Dhe kërkoj që kjo pike të jetë pika 3 e rendit të ditës.

Pastaj kryesuesi pyeti anëtarët e kuvendit se a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës

Meqë vërejtje as plotësime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 25 vota për, aprovoi rendin e ditës së propozuar.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtareve të kuvendit.

Lulzim Rrustemi, kam një pyetje për drejtoratin për shërbime publike për rrugën 4 korsi. Me intereson tash rruga që është bërë 3 korsi a ka diferencë në çmim? Cili është çmimi që po punohet rruga 4 korsi? Dhe e ka pas ndonjë negociim apo dakordim për çmimin për rrugë?

Egzona Bytyqi, po bëhen 15 ditë prej kur ka filluar procesi i vaksinimit në komunën tonë. Kam disa pyetje rreth këtij procesi sa është numri total i të vaksinuarve në komunën tonë? A ka shkuar gjithçka në rregull në bazë të kornizave që ju i keni planifikuar. A keni hasur në ndonjë sfidë apo vështirësi? E di që janë krijuar ekipe mobile që kanë me kryer shërbime shëndetësore për të vaksinuar ata që kanë nevojë nëpër shtëpitë e tyre. Pasi jemi duke u ndjekur live është mirë me u njoftua qytetarët se kush e gëzon të drejtën me u vaksinoi në shtëpi. Tjetra ka të bëjë me një kundërmim të erës sidomos në stinën e verës të rruga nga QMI-ja deri në hyrje të komunës tonë, pasi kam marrë kërkesë nga qytetarët.

Ramiz Qeriqi, punët të cilat po bëhet në teren po bëhen keq, nëse e shikojmë rrugën që është asfaltuar në fshatin Grackë, nuk mund të kalojnë dy vetura. Tjetra të rruga përball komunës punëtorët e kompanisë e përzijshin betonin me dhe e ku e kam njoftuar edhe drejtorin e SHP, e ku i kam edhe fotot, por nuk e di a ka marrë masa. Trotuari ka policia nëse shkon është bërë aq pjertaz sa që është vështirë të kalohet, po ashtu nuk është shtypur hiç me valak. Kur po ka zëvendësime të mësimdhënësve nuk po hapni konkurse por ata mësimdhënës me mësim klasor po e zëvendësoni me mësim lëndor pse? Parqet nuk po mirëmbahen po ashtu edhe shatërvani duhet të lëshohet. Për drejtoratin e Bujqësisë pse nuk ka këtë vit subvencione.

Imri Ahmeti Kryetari i Komunës tha, rruga 4 korsi as nuk mund të negociohet e as të bisedohet por duhet të implementohet sipas çmimeve të ofruara dhe të kontraktuara, pasi që çdo kontratë paraqet mardhnye detyrmore. Në fund të projektit mund të shohim. Por në këtë rrugë punimet do të ndërrehen për shkak të fluksit të shtuar të qytetarëve deri në vjeshtë. Çështja e ngritur rreth erës të rruga deri të QMI-ja na disa herë kemi bërë kërkesa, kemi aplikua bashkë me komunën e Graçanicës për këtë. Nëse ju e dini që ajo pjesë është pronë e komunës së Graçanicës por po presim nga ministria mos po e bënë një zgjidhje. Sa i përket trotuarit nuk e di unë se nuk jam ekspert por mund të bëhet analiza dhe të shikohet se a i plotësojnë cilësinë. Unë disa here ka postuar në rrjetet sociale demolimin e shportave të mbeturinave

dhe drunjve dekorativ dhe ne nuk duhet ta lëvdojmë këtë akt te keq të cilin dikush e bënë. Por ne duhet te lutemi te gjithë qytetarëve qe te kujdesemi se bashku te gjithë.

Ramiz Qeriqi, anësoret rreth rrugës janë me dhjetëra te thyera, unë i kam fotot te cilat ia kam dërguar drejtorit dhe do ja sjelli edhe juve tash ato foto prapë. Dhe ajo firmë duhet të ndëshkohet.

Argjend Tasholli,i kam disa pyetje sipas kërkesave te qytetarëve,pse nuk po fillon të ndërtohet rruga e Lumit në Gadime.Po ashtu lagjja Ukshini, ne Gadime Reqica në Gllavice dhe disa lagje tjera pyesin se kur do te asfaltohen rrugicat e tyre. Sa i keni paisë shkollat me kabinete dhe me rekuizita. A keni angazhuar ndonjë OJQ për luftimin e dukurive negative siç janë droga dhe alkooli. A keni menduar ndonjë herë ndonjë trajnim për nxënësit kundër këtyre dukurive.

Ukë Kryeziu,tha se kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike,për kontratën me operatorin ekonomik për pastrimin e lumenjve, a është e përfshi edhe pastrimin e lumit Sllovi me këtë kontratë

Imri Ahmeti, Kryetari i Komunës, te subvencionet nuk janë dhëne as ne nivel qendror ende. Ndërsa na e kemi publiku a do te aplikoj dikush ose jo nuk e dimë, por telashe o ka shkakton rritja e çmimit te hekurit. Rruga e Lumit ne Gadime kontrata është 3 vjeçare dhe do te asfaltohet shumë shpejtë .Ndërsa ne asnjë pranim teknik nuk e bëjmë pa e bërë A testin. Sa i përket OJQ-ve ne e kemi pas një konkurs publik ku kanë aplikuar disa OJQ dhe janë përzgjedhë ato OJQ qe me projektet e tyre do ti implemetojne. Në Sllovi nuk është i përfshinë i gjithë lumi në Sllovi.

Argjend Tasholli,rruga te lagja Ajeti e cila është e postuar ne rrjete sociale tregon se nuk janë punuar mire ato rrugë.

Imri Ahmeti kryetari i komunës,unë jam për reagime dhe ndihmë te qytetarëve, nëse hyn ne internet e ki kontratën është publike dhe mund ta shihni. Unë nuk kam faj nëse ne disa lagje nuk na lejojnë me shtruar asfalt e me hap kanale.

Argjend Tasholli, te lagja Behluli ne Gadime të Epërme ka pas mundësi me u hap kanalet por ju nuk i keni hap.

Imri Ahmeti, aty ka qene rruga qe i lidhe dy Gadimet, dhe atje kemi pas pengesa nga banoret dhe atë e din e gjithë Gadimja qe nuk na kane lëne me shtruar.

Lumturije Bytyqi-Hasani,pasi qe jemi ne sezonin e verës dhe rritet fluksi i qytetarëve është mirë të bëhet dezinfektimi i sheshit. A ka komuna kontrate qe do te bënte dezinfektimin e sheshit dhe vendeve ma te frekuentuara te qytetit

Albulena Kelmendi,kam pyetje për drejtoreshën e arsimit, pse nuk është hapur konkursi për referent te shkollës kur dihet qe disa kohe ne shkollën e

Gjimnazit mungon kur dihet qe tani jemi ne fazën e regjistrimit te nxënësve dhe nevoja është e madhe për një referent. Pyetja e dytë qysh ka shkuar mësimi plotësues a është mbajte? Dhe një pyetje për drejtoreshën e shëndetësisë cilat kategori janë vaksinuar deri tash dhe a ka pas mundësi me u vaksinuar edhe personat qe kane qene ma te ri,pasi qe unë njoh disa persona qe janë me te ri edhe i kanë marrë te dy dozat e vaksinës.

Hyra Bytyçi, kam një pyetjen për drejtoreshën e shëndetësisë a ka ende persona te prekur me covid-19 në komunën tonë. Dhe sa janë të informuar qytetarët për platformën I Kosova ku mund të regjistrohen dhe sa është procesi i pritjes në rast se regjistrohen.

Imri Ahmeti kryetar i komunës, është pa qe është nevojë për dezinfektim dhe do ta shohim përmes mallrave dhe shërbimeve qe ta shpallim por duhet çdo 6 ditë të bëhet.

Merita Bytyqi,tha se prej datës 15 qershor ka filluar vaksinimi masiv vetëm ditëve të punës. Deri me tani janë vaksinuar mbi 2300 qytetar. Ka pas kapak sfida po me daljen ne sallën e vaksinimit kane shkuar procedura mire. Prioritet kanë për vaksinonim personat e vjetër por edhe personat me sëmundje kronike. Grupet mobile ne fazën e pare i kanë vaksinuar personat me dialize, është vazhduar me ata me aftësi te kufizuara dhe lëmosh kërkuesit. Nuk kemi raste shumë me Covid-19 por virusi vazhdon te jetë te ne.

Imri Ahmeti, personelit administrativ i shkollave nuk trajtohet me ligjin e arsimit por me ligjin e shërbyesve civile dhe te punës,prej vitit te kaluar nuk na kanë lejuar ministria me publiku konkurse as për shërbyes civile as punëtore administrativ.

Elmaze Behluli- viti 2020 ka qenë viti ku janë furnizuar te gjitha shkollat me kabinete dhe me rikuzita sportive e kamera. Prej fillimit te pandemisë e kemi mbajte mësimin plotësues ne te gjitha shkollat. Sa i përket asaj qe e tha parafolësi unë nuk kam informata dhe nuk është e vërtetë.

Ramiz Qeriqi,unë te thash ma herët qe janë disa persona qe janë kane duke dhëne mësim klasor tani janë zëvendësuar me mësimdhënës lëndor.

Argjend Tasholli, ne shkollën fillore “Zenel Hajdini” aty ka kabinete te viteve te 80 asnjëherë nuk janë pajisur me kabinete.

Elmaze Behluli, na në 15 shkolla ju kemi dërguar rekuizita dhe do te dërgohen edhe ne shkollat tjera.

Pastaj u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 44 të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 44 të e Kuvendit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për

Aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja e 44 të e të Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti.

II.

Propozim Vendim për aprovimin e kornizës afatmesme buxhetore për vitet 2022-2024

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadani drejtor DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Lulzim Rustemi, jemi ne shqyrtimin e kornizës afatmesme buxhetore për vitet 2022-2024, i ardhur me kohë dhe një mundësi e mirë për me pa ne cilin stad kemi ardhur për me shikuar një kornizë ne te mire te qytetareve. Kemi një shpërndarje të mirë por unë i kam disa pyetje. Te shpenzimet te projeksionet buxhetore tabela 5 me krahasua me këtë vit ka rritje te madhe te shpenzimeve. Ndërsa zvogëlime te investimeve kapitale. Ne bujqësi kemi projekte te njëjta qe nuk po sjellin risi te qytetarët. Po ashtu ka shumë projekte ne rrugica, ndriçim publik te pa përcaktuara. Është harru lumi Janjevka te hyjë në projekt për pastrim dhe ka një gjatësi 3 kilometra. Te shëndetësia te investime kapitale është një shumë e vogël, nëse e shohim stamatologjine aty nuk mund te kryhet asnjë shërbim. Kuvendi është ai i cili e voton buxhetin ndërsa ekzekutivi e bijnë propozimin në kuvend. Ne jemi te pakënaqur nëse nuk ka përmirësime dhe duhet te përfshihet edhe lumi “Janjevka”.

Lumturije Bytyqi-Hasani, jemi ne fazën e parë te hartimit te kornizës afatmesme buxhetore ,por qasja qysh e ka bërë ekzekutivi e sidomos ne disa fshatra

nuk është e drejtë. Po ashtu çerdhja ne fshatin Shalë është shty për vitin 2023 dhe 2024,kërkoj qe te ndryshohet kjo dhe Shala te ketë çerdhen nge viti 2022. Po ashtu është një kërkesë e të rinjve te Shalës qe te ketë një qendër rinore në Shalë. Ka nevojë ai vend për një Qendër Rinore .Është premtuar qe do te ketë lapidare por si shihet ne këtë kornizë nuk do te ketë të përfshimë lapidarë. Familjet e dëshmorëve presin qe te ju ndërtohet lapidaren dhe unë prej qe edhe lapidari i Zylfije Gashit të ndërtohet. Pse janë hiç nga buxheti projektet për lapidarët

Argjend Tasholli,qe te jetosh me një lokalitet aty duhet te ketë kushte qe te kesh një jete sa me te mire te kesh ujë te pijshëm rrugë te mira kanalizim, e te tjera. Nuk e pash ne këtë buxhet qe e keni parapare përfshirjen e ujit te pijes ne disa rrjete ekzistuese. Ne Marevc kemi disa puse për ujë te pijes ndërsa vetëm një e kemi funksional. Te njëjtin problem me ujë e kane edhe disa fshatra tjera. Po ashtu kemi probleme me kanalizim me disa fshatra e sidomos ne Gadime. Ne arsim duhet te ketë më shumë kabinete e salla sportive,po ashtu edhe në shëndetësi te ketë më shumë investime.

Hyra Bytyçi,sa i përket Vendimit për aprovimin e kornizës afatmesme buxhetore për vitet 2022-2024,jemi pro këtij propozim vendimi dhe ne vlerësojmë se ne qarkoren e pare janë përfshire te gjithë kufijtë fillestar duke marr parasysh te gjitha kërkesat dhe nevojat e qytetareve te dala nga dëgjimet publike buxhetore,sqaq janë fushat sportive, rrugicat, ndriçimi publik e te tjera.

Egzona Bytyqi,para vetës kemi një dokument tepër te rëndësishëm për këto 3 vitet e ardhshme. Edhe unë kam qenë pjesë e dëgjimeve publike buxhetore dhe i kam dëgjuar për se afërmi kërkesat e qytetarëve te cilat kanë qenë tejet racionale. Unë i kam disa te cilat duhet te kenë reflektim nga ana juaj, se pari te shëndetësia te paraprije rritja e gamës se produkteve shëndetësore,investime te kemi ne sferën e diagnostikes sepse është tepër e nevojshme, po ashtu te rritet edhe numri i reagencave qe kane me pas nevojte qytetaret me i kryer. Po ashtu para disa seancave e pata ngrit çështjen rreth blerjes se një aparati për matjen e cilësisë se ajrit po besoj qe tash ka me gjet vend ky dhe ka me u kryer kjo. Kemi kërkuar ndërtimin e një çerdhe ne Magure .Po ashtu edhe çështjen e ujësjellësit ne Qylage,rrregullimi i shtratit te lumit dhe asfaltimi i rrugicave. A fillon kolektori i ujërave te zeza ne vitin 2021?

Imri Ahmeti kryetari i komunës,na jemi ne fazën e pare te kornizës buxhetore dhe projektet shtohet me bashkëpunime ridestinin e rishikim. Asfaltimet po përfundohen dhe do te fillojmë me mirëmbajtje dhe ambient e projekte tjera. Debatet qe organizohen ne i marrim edhe prioritetet. Unë po ndihem mire qe po kalojme nga një buxhet i asfalteve ne një buxhet inventiv. Ne e kemi ne prioritet edhe ne Shale dhe Magure çerdhen.

Ukë Kryeziu,kemi kornizën afatmesme buxhetore dhe ky është momenti ku ne mundemi me i dhëne propozimet tona dhe me ndryshuar aty ku është e nevojshme

dhe e arsyeshme deri ne aprovim te buxhetit. Sa i perket sferes se arsimit ne sSllovi po perfundon e gjitha mirepo ne shendetesi duhet te rriten kapacitete dhe te perfshihen fshatrat afër dhe te behet QKMF ne Sllovi te rritet sherbimi dhe kapacitetet dhe te behet si ne fshatrat tjera te medha. Te infrastruktura është problem projekti i pa perfunduar i rruges Sllovi- Lipjan dhe është mirë të behet rikonstruktimi i asaj rruge. Po ashtu duhet te behet një kolektor i ujërave te zeza për disa fshatra për vitet ne vijim.

Nazmi Krasniqi,kjo kornize ka qene dhe ne debate publike,por edhe qytetaret nuk po janë edhe aq shume te interesuar. Por është mirë qe te shikohet kërkesat te cilat janë ma te arsyeshme e sidomos rreth arsimit dhe shendetesisë.

Imri Ahmeti kryetar i komunës, ne nëse i shtojmë mjete ne arsim e ne shendetesi na diku duhet me i zvogëlua, tash ne do te qojmë mjetet me shume ne arsim dhe shendetesi,pasi qe shumica e punëve tjera veç janë perfunduar. AMF me kaluar ne QMF në Sllovi jam për,por kërkohet qe te jene 10 mijë banore. Po edhe për rrugën ne Sllaovi- Lipjan duhet me hy ne rikonstruktim dhe me kryer. Unë pres çdo propozim dhe ide tuajën.

Albulena Kelemdni, parafolësit e partive opozitare veç i thane ato qe janë shqetësime edhe tonat. Nëse kemi marr pjese ne dëgjime publike nuk do me thane qe janë marr parasysh kërkesat tona. Secili projekt i rëndësishëm,është i mirëseardhur dhe e përkrahim. Investime janë bërë në shkolla por cilësia ka qenë e dobët, po ashtu shkollat kane nevojë për kabinete. Po ashtu edhe ne shendetesi ka nevojë te rriten investimet .

Nazmi Krasniqi,ne cilën shkolle kemi ndonjë kabinet te kimisë apo te biologjisë i cili është ne rregull dhe koha është te investohet ne kabinete nëpër shkolla.

Lulzim Rustemi,na nuk jemi ne kuvend vetëm për debate por duhet te ketë specifikime se ku duhet te investohet dhe presim qe te ketë përmirësime ndryshe na do te abstenojmë si grup.

Imri Ahmeti kryetari i komunës,ju e dini qe tavanin buxhetor na e cakton ministria, unë e kam emërtua investime ne qytat dhe fshatra për shkak te shkurtimit te proceduarave, se nëse na për çdo rrugice shpallim projekt detal duhet 23 proceduar administrative mi kaluar. Ma mire këto mjete me u shpenzuar për qytetaret e Lipjanit se ma na humb këto mjete.

Lulzim Rustemi,këtu kemi projekte ndërtimi u rrugëve,ndriçimi publik ne qytet dhe fshatra, na po i ndajmë mjetet po ju po vendosi se ku keni me i qu. Qytetarët nuk po e dine se ne cilat lokalitet po shkojnë këto mjete.

Imri Ahmeti kryetar i komunës, unë mundem me i shënuar te gjitha fshatrat ne liste por a është ne rregull. Arsyeja pse nuk janë shënuar secila veç e veç është me i shkurtuar procedurat pasi qe shumica e këtyre rrugëve nuk kanë emra. Po ashtu ka

shtëpi që janë ndërtuar vone. Nuk do të jetë asnjë rrugicë pa shtruar as në qytet as në fshatra

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 17 vota për 9 abstenime aprovoi.

Shtesë:Vendimi.

Pastaj kryesuesi dha pauze nga ora 12:15 deri në 13:45

Pas pauzes,u vazhdua me pjesën e dytë të mbledhjes me pikat në vazhdim

III

Propozim Vendim për Ridestinimin e mjeteve.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadanit drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani,unë edhe në KPF e kam ngrit një shqetësim të banorëve të fshatit Akallap për rrugën Ibrahim Gashi me gjatësi diku 400 metra. Rruga të varrezat që është kërkesë e këtyre banorëve, propozoj që kjo të përfshihet në këtë propozim vendim,sepse është urgjencë dhe kërkesë e qytetarëve.

Albulena Kelmendi,na e kemi diskutuar edhe në KPF këtë pikë,derisa nuk specifikohen projektet se ku do të shkojnë mjetet nuk do ta marr aprovimin e grupin tonë.

Hyra Bytyçi,ne si grup i LDK-s e kemi shqyrtuar këtë propozim vendim dhe në konsiderojmë se këto mjete po shkojnë në mënyrë optimale,e të cilat janë të nevojshme për përmirësimin e nevojave të qytetarëve të komunës së Lipjanit.

Lulzim Rrustemi,një shumë e mjeteve ridestinohet në projekte të reja,por a po dihet ku po shkojnë këto mjete, 3 projekte 100 mijë euro dhe nuk po dihet ku po shkojnë nuk ka lokacion. Në nuk e përkrahim si grup këtë propozim.

Afrim Miftari,e kam një kërkesë që të Gadime të rruga “Egzoti 99” të përfshihet një pjesë e trotuarit e cila ka mbet pa u përfunduar të shikohet mundësia të futet kjo pjesë,kisha propozua që të asfaltimi në lagje dhe fshatra të përfshihet kjo pjesë e rrugës në fshatin Gadime.

Latif Ramadani, na kane mbet një numër i vogël i rrugicave te pa asfaltuara dhe me këtë asfaltimi i rrugicave do të përfshihen te gjitha rrugicat e qytetit dhe fshatrave, në këtë do te përfshihet dhe rruga në Akllap.

Lumturije Bytyqi, ne kuadër të këtij projekti a do te asfaltohet rruga në Akllap me ridestininim.

Alban Salihu, një sqarim te rruga Lipjan Janjevë deri te udhëkryqi rreth ne disa here e kemi ngrite ne kuvend dhe ju keni thane qe i takon nivelit qendror ministrisë se infrastrukturës ndërsa tash koka përfshi trotuari çka ka ndodhe me këtë rrugë ju ka ndryshuar statusi apo janë afrua zgjedhjet.

Lulzim Rrustemi,ekzekutivi e bien vetëm propozimin dhe drejtoritë duhet me ditë gjendjen ku të shkojnë mjetet dhe na kuvendi e votojmë ose jo.

Nazmi Krasniqi,qe 8 vite e ma shumë unë kam kërkuar disa herë qe të bëhet një komision për emërtimin dhe riemërtimin i rrugëve dhe ende nuk është bërë ai komision. Dhe nuk do te kishe telashe ne investim te rrugëve pasi qe do ti kishin emrat.

Daut Azemi, na kemi pas vullnet ta bëjmë komisionin por nuk mundemi me ndërruar ne sistem te adresave por pa na dhëne leje nga ministria na nuk mundemi me bo asgjë pa na u dhëne leja nga ministria përkatëse.

Argjend Tasholli, kam një pyetje çka është për juve prioritet uji i pijes apo ndriçimi publik në fshatra. Pse te ndriçimi publik nëpër fshatra nuk e zëvendësoni me ndonjë projekt te ujit te pijes.

Latif Ramadani,shumë projekte janë përfunduar e te cilat për dika janë doke vetëm ëndrra. Do të bëhet çdo rrugë qe është e nevojshme për banorët por ashtu edhe kjo në fshatin Akllap. Qeveria është dashtë me lejuar me pas rishikim te buxhetit po ashtu grandin specifik te shëndetësisë është dashtë me rritë. Për neve janë prioritet ajo qe vjen ne bazë të kërkesave te qytetarëve.

Argjend Tasholli, nëse i ke përcjell debatet gjate fushatës te kryetarit ka qene ujë te pijshëm 24 ore,. A ma prioritet për fshatra është me funksionalizuar ujësjellësin apo me rregulluar ndriçimin publik.

Alban Salihu, për shëndetësi nga qeverisja juaja nuk është siguruar asnjë vaksinë ndërsa qeverisja jone deri tan ika siguruar shume vaksina. Kjo qeverisja ka shtruar asfalt edhe ndriçim por ajo është bërë me taksat e qytetarëve.

Latif Ramadani, na kena premtuar Magurës nëse e marrim pushtetin do te keni ujë te pijes dhe tani kane ata ujë te pijes. Këto mjete kane mbet nga projektet e kaluara dhe do te shkojnë atje ku ka nevojë. Çka do te bëjnë pleqtë me pensionet qe ja keni ndal po ashtu çka do të bëjnë ata fëmijët qe i presin shtesat e fëmijëve qe ja keni premtua ju e nuk po ua ndani çka me ju thane atyre.

Daut Azemi, ju kisha lut qe mos kaloni jashtë rendit te ditës mos flisni për nivel qendror se do ua ndali fjalën.

Alban Salihu,thua ju fëmijëve tuaj qe baba juaj ka prite qe 20 vite ,pritni dhe ju 6 muaj.

Latif Ramadani,unë kur me pyet fëmija im i them qe qeveria na ka gënjye me premtimin e tyre.

Ramiz Qeriqi, ju kish lutë mos boni fushatë, mos dilni jashtë rendit te ditës, nëse doni te bëni fushatë na po dalim jashtë, edhe kur po kryetari në mbledhje ju asnjë nuk po guxoni me marr faljen me debatuar.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 21 vota për, 4 kundër dhe 4 abstenime, aprovoi:

Shtesë:Vendimi.

V

Propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e shtëpisë te komunitetit ne vendbanimin ne Gandime te Ulët

Propozim rregullore për transparencën ne komunë

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Sefer Tasholli, drejtor për GJK, i cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi:

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Argjend Tasholi,ne si grup i PDK-së këtë propozim do ta përkrahim por fillimisht kërkojmë disa sqarime, çfarë lloji i shtëpisë do të jetë kjo cilat aktivitete do te zhvillohen për cilat komunitete do te ndërtohet,pasi sipërfaqja prej 5 ari është e vogël dhe do te ishte mire qe ta rrisim atë sipërfaqe. Komunitetet në Gadime kanë harmonie ne mes vete dhe nuk ka pas kurrë dallime dhe ne nuk do te lejomë qe aty te ketë dallime mes komuniteteve. Ne do ta përkrahim këtë propozim pasi ne jemi për te mirën e Gadimes dhe te qytetareve qe jetojnë aty.

Fehmi Rexhepi,ky është një projekt shumë i qëlluar për komunitetin ashkali pasi qe çdo takim apo projekt qe e ka pas komuniteti,nuk kanë pas ku me mbajte takime dhe me këtë po ju lehtësohen punët komunitetet. Ju falënderoj te gjithëve ne emër te komunitetet për iniciativën qe keni marrë, po ashtu pres qe ta përkrahi këtë propozim vendim.

Sefer Tasholli në Gadime te gjitha komunitetet janë bashkërisht dhe aty nuk ka ndarje mes komuniteteve. Objekti qe do te ndërtohet aty mjafton 5 ari dhe ai do të ndërtohet për aktivitete te ndryshme për nevojat komuniteteve.

Lulzim Qerimi,bëhet fjalë për një shtëpi model qe ne te ardhmen te merret model për shtëpi. Pjesëtarët e komunitetit ashkali kane gjendje jo te mire dhe aty pritët qe ne te ardhmen te themelohet një organizate jo qeveritare dhe ajo do te merret me aktivitete për komunitetet .Kjo shtëpi do te mirëmbahet nga DKR-ja

Nazmi Krasniqi,një projekt i qëlluar dhe na e përkrahim këtë propozim vendim. Është mirë ne te ardhmen te gjinden edhe një hapësire për shkollë ne at vend.

Sefer Tasholli, unë e du shkollën dhe ne atë kohe e kam kundërshtua shkollën qe te ndërtohet në atë vend se nuk ka qen vendi i duhur.

Nazmi Krasniqi, na nuk kena gjet vend dikun tjetër dhe ju Gadimja nuk keni lejuar qe te jetë një aneks shkolle ne atë vend.

Megë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për, aprovoi:

Propozim rregullore për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Merita Bytyqi drejtoreshë e DSH i cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi:

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Egzona Bytyqi, ne si grup i PDK-së e kemi shqyrtuar këtë propozim rregullore dhe në mënyrë unanime ne e votojmë.

Majlinda Sylejmani, ne e kemi shqyrtuar këtë propozim rregullore e përkrahim, na vjen mire qe komune jone po e promovon këtë model te qeverisjes e cila është në shërbim te të gjithë qytetarëve.

Ramiz Qeriqi, me vend kjo rregullore por unë nuk mendoj qe do te mund te ju ndihmojmë fëmijëve pasi qe deri ne moshën 18 vjeçare fëmijët qe po i kane prindit pa pune po detyrohen te punojnë qofte kamarjer apo punëtor krahu. Unë do ta votoj këtë rregullore.

Merita Bytyqi,me këtë rregullore do te kujdesen qe te zbatohet punëtoret e qendrës për pune sociale punëtoret e arsimit dhe zyrtar ligjore për masat qe do ti ndërmarrin.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për, aprovoi:

Shtesë:Rregullorja.

IV

Propozim rregullore për transparencën ne komunë

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Bekim Shabanit , drejtor për EZH, i cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi:

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Ramiz Qeriqi,kjo rregullore nuk është duke u zbatuar ne praktike sidomos neni 4 i kësaj rregullore ku thuhet se mbledhjen e kuvendit te komunës janë ta hapura për publikun. Komuna përmes faqes zyrtare transmeton mbledhjet e kuvendit te komunës,e qe ndodhe qe shpesh here nuk transmetohen mbledhjet e kuvendit dhe shihet qe këtu nuk ka transparencë.

Lulzim Rrustemi,ne si GP i PDK-s, gjithmonë jemi për transparencë dhe e përkrahim këtë rregullore. Por duhet te tërheqim vërejtjen se transparenca ne komunën e Lipjanit po mungon, transmetimi i mbledhjeve po mungon nuk po publikohen dhe kjo o shkelje ligjore. Dhe kam pyetje pse seancat nuk po publikohen.

Daut Azemi,gjatë punimeve ne rrugën përballë komunës, kemi pas probleme me rrjet, ngjizmi do te behet vetëm me audio video jo live. Do ta bëjmë një sistem te ri te kamerave po ajo besoj do te behet ne komunën e re.

Bashkim Budakova, sa i përket rregullores për transparencë isha ndal te neni 3 pika 1.6 te peticionet ku thuhet se janë kërkesa kolektive me shkrim që i adresohen komunës respektivisht Kuvendit të komunës, nga një grup i interesit apo organizata, rreth së cilës çdo çështje që ka të bëjë me përgjegjësitë e komunës me qellim që ajo të ndërmarrë ndonjë veprim ose përmbahet nga ndonjë veprim. A ka pasur ndonjë peticion qe ka qenë i arsyeshëm ne këtë kuvend dhe pse nuk pas pas deri tani asnjë peticion ne këtë kuvend. Po ashtu per shkak te mos transparences

nuk kemi pjesëmarrje ne dëgjime publike të qytetareve e ku kam marr pjesë edhe unë vet dhe nuk janë marr parasysh. Na e përkrahim këtë rregullore por jo te jetë vetëm letër po te zbatohet ne praktike.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për, aprovoi:

Shtesë:Rregullorja.

VI

Propozim rregullore për taksat komunale

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Bekim Shabanit, drejtor i DEZH, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Rregullorja.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi,kam një sqarim te taksat komunale për shfrytëzimin e tokës për bagëti a o fjala për pronat komunale.

Daut Azemi, këto janë taksa te parapare me ligj dhe kane ardhe nga ministria kështu.

Bekim Shabani, është fjala nëse jepet ne shfrytëzim prona komunale për bagëti.

Nazmi Krasniqi, për ata qe kane bërë shpuarje te rrugëve a kane bere ndonjë pagese te taksës sipas rregullores a ke naj informate

Bekim Shabani, po te gjitha taksat janë duke u paguar nga ata qe janë duke i shfrytëzuar

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25, aprovoi:

Shtesë: Rregullorja.

Propozim Vendim për anulimin e vendimit 15Nr .30-30026 për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmërive në funksion tëndërtimit të segmenteve rrugore “ Afrim Zhitia ” , “ Mbreti Zog ” dhe “ Kongresi i Blinajës ” në Lipjan

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Sefer Tasholli, drejtor për GJK, i cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi:

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, ne si grup i PDK-së se kemi votuar edhe herën e parë, por ne shkresën e ministrisë ceket që prona shoqërore nuk mund të shpronësohet nga kryetari e cila nuk është cekur në arsyetim hiç.

Sefer Tasholli, prona për momentin nuk është e AKP-së por është e një qytetari e blerë për 99 vite. Por nuk e di a e ka njoftuar zyra ligjore ministrinë për këtë ose jo.

Megjithatë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24, aprovoi:

Shtesë: Vendimi.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15,³⁰

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi